



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
MBLEDHJA E GJYQTARËVE**

Nr. 1320 Prot.

Tiranë, më 20.12. 2019

VENDIM

“I Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit”

Nr. 28, datë 20.12.2019

Në zbatim të nenit 8 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelitit të Gjykatës Kushtetuese” dhe të nenit 10 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”, Mbledhja e Gjyqtarëve,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për organizimin e funksionimin e personelit dhe administrimin e dokumentacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit”, sipas tekstit bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Natasha Mulaj



Për një shtesë në rregulloren “Për organizimin e funksionimin e personelit dhe administrimin e dokumentacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”

Në mbështetje të nenit 8 të rregullores “ Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, Mbledhja e Gjyqtarëve,

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 20, pika 7, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me përmbajtjen si më poshtë:

“Përditëson statistikën për numrin e çështjeve që i janë caktuar me short secilit gjyqtar, në rolin e relatorit, nga fillimi i procesit të rivlerësimit në Kolegj”.

Neni 2

Ndryshimet në këtë rregullore hyjnë në fuqi në datën e miratimit të Vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe efektet e tij fillojnë nga data 08.01.2020.